



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 33, 34 dhe 35 të Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe Rregullores Nr 07/2016 për suvencionimin e projekteve filmike të QKK-së shpall:

KONKURS PËR FILM TË METRAZHIT TË GJATË – DOKUMENTAR (mbi 60 minuta) Ref. Nr. QKK-02/2019

Për subvencionim të projekteve kinematografike të filmit të gjatë dokumentar, për vitin 2019. Të drejtë konkurimi kanë të gjithë personat juridik, vendës ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit dhe paraprakisht të regjistruar në QKK dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë konkurs.

I. Aplikimi bëhet online në linkun www.qkk-rks.com, ku ndër të tjera në aplikim kërkohen:

1. Testi i kulturës;
2. Buxheti;
3. Sinopsisi;
4. Tritmenti apo skenari;
5. Koncepti Regjisorial;
6. CV të autorëve kryesorë;
7. Dëshmia e pagesës së aplikimit 100.00 € (njëqind euro).

II. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE

1. **Shtëpitë filmike dhe producentët** që janë me vonesë në zbatimin e kontratës me QKK-në për projektet e fituara më parë, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje me më shumë se dy projekte brenda vitit, projektet duhet të jenë të kategorive të ndryshme.
3. Një producent ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
4. Një regjisor ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
5. I njejt person nuk mund të jetë regjisor dhe producent i të njejtit projekt.

6. Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje, në cilësinë e regjisorit.
7. Personat që aplikojnë në cilësinë e regjisorit në një projekt, nuk kanë të drejtë të aplikojnë në cilësinë e producentit në një projekt tjetër dhe anasjelltas.
8. Filmat televiziv të metrazheve dhe zhanreve të ndryshme nuk kanë të drejtë pjesëmarrje/aplikimi.
9. Projektet që janë refuzuar dy herë nuk kanë të drejtë aplikimi.
10. Si dhe kriteret tjera të parapara me rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike të QKK-së.

Vërejtje - referuar Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit: punëtorët e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucioneve vartëse të saj, nuk kanë të drejtë aplikimi në Konkurs.

Data e fundit për aplikim është: **19 MAJ 2019**

Mënyra e pagesës së aplikimit:

Fletëpagesa merret në zyret e QKK-së.